

INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET



për një partneritet horizontal të institucioneve me qytetarët

Eksperiencia e zbatimit “të trekëndëshit” mbështetet në përvojën vendase • Takimet online mbështetën plotësisht nevojën e një procesi rregullator për partneritetin horizontal bashki-polici-prokurori • Qëndrueshmëria e “trekëndëshit” mund të sigurohet me ligj, përmes një Marrëveshje Mirëkuptimi, apo Vendim të Këshillit Bashkiak, asnjëra prej tyre nuk përjashton tjetrën • Përfitues nga ky partneritet (pa kosto financiare) janë institucionet dhe qytetarët



Z. AHMED ABOUTALEB, KRYETARI I BASHKISË SË ROTERDAMIT

- Në modelin holandez ligji parashikon se kryetari i bashkisë është kryetari i “trekëndëshit”. Kryeprokurori, kryetari i bashkisë dhe shefi i policisë janë partnerët kryesorë të “trekëndëshit” dhe kjo nuk do të thotë që kryetari i bashkisë është shefi, pasi vendimet merren së bashku dhe në varësi të rastit. Këshilli i Bashkisë e merr përgjegjësinë përmes kryetarit të bashkisë dhe harton projekte por edhe legjislacionin vendor për të ndihmuar kryetarin për të zbatuar rolin e tij kur bëhet fjalë për rendin publik në qytet. Ai theksoi se të gjithë janë të barabartë në atë “trekëndësh” dhe të gjithë mund të ndërmarrin iniciativën për të ftuar të tjerë në takim.



ZJ. GUUSJE KORTHALS ALTES, AMBASADORE E MBRETËRISË SË VENDEVE TË ULËTA (HOLANDËS)

- Takimet e organizuara nga IDM në qytete të ndryshme të vendit mundësuan përfaqësimin e një vizioni të përbashkët të partnerëve të “trekëndëshit” dhe inkurajoi integrimin e këtyre takimeve në një formë më të strukturuar.



Z. ERION VELIAJ, KRYETARI I BASHKISË TIRANË

- Ekziston një ndryshim midis përvojave, pasi në Rotterdam takimet konsultuese përcaktohen me ligj. Edhe nëse kryetari i bashkisë, shefi i policisë dhe prokurori nuk e pëlqejnë njëri-tjetrin, ata duhet të punojnë së bashku. Z. Veliaj shtoi se ky nuk është rasti në Shqipëri, prandaj duhet parë sesi mund të shkohet nga bashkëpunimi ad hoc aktual në një rregullim të përhershëm.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 7
Integritet
Llogaridhënie
Partneritet

Qershor 2020

Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Anxhela Bruçi, Asistente Projekti

Redion Qirjazi, Kontribues

Armela Xhaho, Kontribuese

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241

Shënim:

Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.

ZJ. GUUSJE KORTHALS ALTES: MODELI
HOLANDEZ I “TREKËNDËSHIT”
PO REZULTON I SUKSESSHËM NË
SHQIPËRI 4

Z. AHMED ABOUTALEB: REZULTATE
MË TË LARTA ARRIHEN NGA TAKIMET
ME QYTETARËT DHE NDËRVEPRIMI
ME PARTNERËT KRYESORË TË
“TREKËNDËSHIT” 5

Z. ERION VELIAJ: NË SHQIPËRI DUHET
TË KALOHEM NGA BASHKËPUNIMI
AD HOC NË NJË RREGULLIM TË
PËRHERSHËM 6

ZJ. VOLTANA ADEMI: NJË VENDIM
I KËSHILLIT BASHKIAK PËR
FORMALIZIMIN E TREKËNDËSHIT NË
NIVEL BASHKIE 7

ZJ. ROMINA KUKO: KËSHILLAT
VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE
TË VIHEN NË FUNKSION TË
PARANDALIMIT TË KRIMIT 7

Z. IDRIZ HAXHIAJ: FORMALIZIMI I
“TREKËNDËSHIT” TË MBËSHTETET NË
PROCEDURA INSTITUCIONALE DHE
AKTE LIGJORE DHE NËNLIGJORE 9

Z. BILBIL MEMA: DUHET
MATERIALIZUAR “TREKËNDËSHI”
PËRMES TRAJNIMEVE TË
VAZHDUESHME NË AKADEMINË E
SIGURISË 10

Z. SOKOL STOJANI: KJO QASJE
PARANDALUESE ËSHTË NË LINJË
ME VIZIONIN E PROKURORIT TË
PËRGJITHSHËM 11

ZJ. PRANVERA PUSTINA: BESIM NË
ROLIN E “TREKËNDËSHIT” PËR TË
RRITUR KONSULTIMIN ME QYTETARËT
E GRUPET E INTERESIT 13

Z. GLEDIAN LLATJA: TAKIMET E
“TREKËNDËSHIT” I MUNDËSOJNË
QYTETARËT QË TË NJIHEN ME PUNËN
E INSTITUCIONEVE VENDORE 13

Z. SOTIRAQ HRONI: TAKIMET
PERIODIKE DHE PUBLIKE TË
“TREKËNDËSHIT” BASHKI-POLICI-
PROKURORI SI BAZË PËR NDËRTIMIN
E AGJENDËS VENDORE TË SIGURISË 14



Dr. Frank Harris, DCrimJ, MSc, konsulent i lartë pranë SPAK, e quajti të shkëlqyer punimin e IDM-së, mbi rolin e takimeve të “trekëndëshit” polici-bashki-prokurori në parandalimin e krimit dhe sigurisë publike, i cili nxjerr në pah meritat dhe avantazhet e dukshme të asaj që Tony Blair e quajti qasjen e ‘integruar nga poshtë’ për të trajtuar çështjet e krimit dhe sigurisë publike në nivel lokal. **Një inovacion i tillë politikash në Shqipëri do të krijonte horizonte të reja në trajtimin e një sërë problemesh, veçanërisht kultivimin dhe përdorimin e drogës, kriminalitetin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Dr. Harris ishte veçanërisht mbështetës për rritjen e rolit të prokurorëve, duke inkurajuar funksionin e tyre si ‘hetuesit kryesorë’ sipas Kodit të Procedurës.**



ÇFARË TRAJTON KY NUMËR I BULETINIT?

Për një partneritet horizontal të institucioneve me qytetarët

Gjatë periudhës 2018-2019, IDM pilotoi me sukses modelin e “trekëndëshit” të takimeve konsultuese për parandalimin e krimit dhe sigurisë publike. Modeli konsiston në takime publike dhe periodike të strukturave të pushtetit vendor, Policisë së Shtetit, dhe prokurorive të rrethit gjyqësor me qytetarë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të tillë si: institucionet arsimore, grupe të ndryshme interesi dhe shoqërinë civile.

Modeli i zbatuar në një të tretën e njësive të vetëqeverisjes vendore krijoi një përvojë të rëndësishme që u mbështet nga të gjithë aktorët duke evidentuar pamjaftueshmërinë e praktikave të qëndrueshme, veçanërisht në nxitjen e partneriteteve të hapura midis institucioneve publike dhe qytetarëve.

Megjithëse mund të thuhet se praktika frymëzohet nga ajo që në Holandë njihet si “trekëndëshi i artë”, përvoja e aplikuar nga IDM është tërësisht e mbështetur në legjislacionin dhe praktikat vendase. Eksperienca e deritanishme në 19 bashki të vendit nuk ka krijuar asnjë sforcim dhe gjithçka është realizuar nga vetë institucionet. Takimet konsultuese të “trekëndëshit” përbëjnë një risi pasi nuk mbështeten vetëm në traditën dhe mënyrën e organizimit të pushtetit në Shqipëri, por përbëjnë një përpjekje të drejtpërdrejtë për të operacionalizuar dhe rritur efektivitetin e infrastrukturës së sigurisë në nivel lokal. Ato nxisin kohezionin midis detyrimeve të bashkisë për shërbime sa më cilësore për mirëqenien e qytetarëve, ndarjen e pronësisë së planit të veprimit për policimin në komunitet me aktorët e tjerë nga ana e komisarariatit të policisë dhe punës së prokurorisë për edukimin dhe informimin ligjor të shoqërisë.

Në të gjithë takimet e IDM-së, por edhe në dokumentin e politikave, referencë kryesore i bëhet fuqizimit dhe shndërrimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) në “qendër të vlerësimit të prioritetëve të sigurisë vendore” për një vendimmarrje dhe veprim më efikas të institucioneve. Gjithashtu, përmes takimeve publike të “trekëndëshit” sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në këtë vendimmarrje.

Në këtë kontekst, ky numër i Buletinit paraqet një përmbledhje të reflektimeve dhe diskutimeve të tre takimeve konsultuese online të zhvilluara gjatë muajit qershor 2020 me përfaqësues të lartë të Prokurorisë së Përgjithshme, Policisë së Shtetit dhe mbi gjysmën kryetarëve të bashkive në vend.

Axhenda e këtyre takimeve u mbështet më së shumti në rekomandimet e dokumentit të politikave të hartuar nga IDM mbështetur në përvojën e zbatimit të “trekëndëshit” në Shqipëri.



ZJ. GUUSJE KORTHALS ALTES: MODELI HOLANDEZ I "TREKËNDËSHIT" PO REZULTON I SUKSESSHËM NË SHQIPËRI



Zj. Guusje Korthals Altes, Ambasadore e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta (Holandës), gjatë takimit me prokurorët më datë 3 qershor 2020, i cilësoi takimet e mbajtura nga IDM si një kontribut të suksesshëm dhe pozitiv në parandalimin e krimit dhe rritjen e sigurisë publike. Ambasadorja ndau me pjesëmarrësit përvojën e saj në takimet e mëparshme të "trekëndëshit". Ajo theksoi se gjatë dy viteve të fundit u organizuan disa takime të "trekëndëshit" me qytetarët dhe ato ishin të suksesshëm në dhënien e rezultateve konkrete. Ambasadorja theksoi se me ndihmën e IDM-së u organizuan takime në qytete të ndryshme dhe se këto takime mundësuan përfaqësimin e një vizioni të përbashkët të partnerëve të "trekëndëshit".

Ambasadorja solli shembullin e Holandës ku takimet e "trekëndëshit" midis kryetarëve të bashkive, policisë dhe prokurorëve ishin një praktikë e përfshirë edhe në legjislacion. Qasja bashkëpunuese lejoi që të identifikoheshin përparësitë vendore në fushat e rendit publik, sigurisë dhe parandalimit të krimit dhe që institucionet të jenë në kontakt me qytetarët. Ajo theksoi se përvoja e modelit holandez të "trekëndëshit" ishte një nga arsyet pse ambasada vendosi të punojë me IDM-në.

Gjatë takimit të datës 10 qershor 2020 me përfaqësues të lartë të Policisë së Shtetit, Ambasadorja reflektoi lidhur me përgjigjen pozitive të Prokurorëve ndaj takimeve konsultuese të "trekëndëshit". Ajo theksoi se lufta ndaj krimit dhe siguria publike nuk janë vetëm përgjegjësi e policisë, por edhe e komunitetit. Në takimin e datës 17 qershor 2020 me kryetarët e bashkive, ambasadorja e cilësoi si domethënëse prezencën e kryebashkiakut të Roterdamit në këtë takim, pasi ishte ai që me vizitën e tij në Shqipëri frymëzoi implementimin e "trekëndëshit" në vend. Ambasadorja shtoi se këto përvoja të para pozitive do të inkurajojnë integrimin e këtyre takimeve të "trekëndëshit" në një formë më të strukturuar.

Z. AHMED ABOUTALEB: REZULTATE MË TË LARTA ARRIHEN NGA TAKIMET ME QYTETARËT DHE NDËRVEPRIMI ME PARTNERËT KRYESORË TË "TREKËNDËSHIT"

Kryetari i Bashkisë së Roterdamit, z. Ahmed Aboutaleb¹ shprehu kënaqësinë për prezencën e tij në takim dhe që vizita e tij Shqipëri në 2017 ka nxitur debatin se si të organizohet një sistem më i mirë i sigurisë për qytetarët.

Në takim, ai theksoi se nuk mund të merret një zakon i caktuar në një vend dhe të vendoset në një vend tjetër, për shkak të ndryshimeve në kulturën politike, mënyrën e strukturimit, dhe e ndarjes së pushtetit në një vend. Në këtë kontekst, Z. Aboutaleb përmendi disa avantazhe të "trekëndëshit" në sistemin holandez. Avantazhi i parë lidhet me atë që Holanda ka një sistem të decentralizuar të ndarjes së pushtetit duke cilësuar se kur bëhet fjalë për policinë dhe zbatimin e ligjit rezultati më i mirë që mund të arrihet në nivel lokal nuk llogaritet duke parë se sa i mirë është një kryeministër apo një president, pasi ata janë shumë larg nga terreni. Ai shtoi se avantazhi tjetër është se në ligj kryetari i bashkisë është kryetari i "trekëndëshit". Kryeprokurori, kryetari i bashkisë dhe shefi i policisë janë partnerët kryesorë të "trekëndëshit" dhe kjo nuk do të thotë që kryetari i bashkisë është shefi, pasi vendimet merren së bashku dhe në varësi të rastit. Avantazhi i tretë është se Këshilli i Bashkisë e merr përgjegjësinë përmes kryetarit të bashkisë dhe harton projekte por edhe legjislacionin vendor për të ndihmuar kryetarin për të zbatuar rolin e tij kur bëhet fjalë për rendin publik



në qytet. Rendi publik nuk lidhet vetëm me demonstratat, por edhe me bizneset, baret, me prostitucionin dhe trafikun e drogës. Kryebashkiaku i Roterdamit theksoi se ata kanë një legjislacion lokal që u jep autoritetin për ta përshtatur me punën e tyre. Kështu që mbliidhen tre sistemet më të mira së bashku për t'i bërë gjërat të funksionojnë. Ai theksoi se të gjithë janë të barabartë në atë "trekëndësh" dhe të gjithë mund të ndërmarrin iniciativën për të ftuar të tjerë në takim.

Kryebashkiaku i Roterdamit shtoi se nëse duhen rezultate të larta duhet të ketë takime me qytetarët, në lagjet e tyre. Z. Aboutaleb tregoi se në tre muajt e fundit vendosi të shkojë në pjesën më të rrezikuar të qytetit dhe të ketë një zyrë atje për të punuar një ditë në javë. Ajo që evidentoi kryebashkiaku ishte që nëpunësit civil, policia, njerëzit që pastrojnë qytetin, të gjithë u angazhuan

••••

1 Ahmed Aboutaleb është kryetar i bashkisë së Roterdamit që prej vitit 2009. Me prejardhje nga Maroku dhe i transferuar në Holandë në moshën 15 vjeçare, ai është kryetari i parë i një bashkie të madhe në Holandë me origjinë nga një familje emigrantësh dhe i besimit mysliman. Ai është mbështetës i zëshëm i lirisë së mendimit lirisë së fesë dhe parimit të mos-diskriminimit. Gazeta e njohur "The Guardian" e ka cilësuar si "Obama i Roterdamit".

dhe kjo krijoi një vlerë të shtuar. Ai ishte në dijeni që Shqipëria ishte ende në diskutime për përfshirjen e “trekëndëshit” në kornizën ligjore, sepse kur gjërat shkojnë keq dikush duhet të mbajë përgjegjësi dhe të parashikohet në ligj përgjegjësia e autoriteteve.

Z. Aboutaleb theksoi se në këndvështrimin e tij ka disa lloje të llogaridhënies. E para i drejtohet qytetarëve. Qytetarët mund t’i kërkojnë llogari kryebashkiakëve për veprimet e tyre. Lloji tjetër i llogaridhënies, që sipas z. Aboutaleb është se demokracia më e lartë e sistemit lokal është Këshilli i Bashkisë, edhe nëse Kryetari zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët ai duhet t’i japë llogari Këshillit të Bashkisë. Parlamenti, zëri i qytetarëve në Këshillin e Bashkisë duhet t’i kërkojë llogari kryetarit të bashkisë për veprimet, neglizhencat apo mosveprimet edhe

nëse kryetari është i zgjedhur. Niveli i besimit ndërmjet Këshillit dhe kryetarit të bashkisë i cili kryeson këto takime është i rëndësishëm, sepse mënyra për t’i bërë pyetje kryeprokurorit është përmes kryetarit të bashkisë. Ai ja përcjell pyetjet prokurorit dhe më pas kryetari i bashkisë ia përcjell ato qytetarëve. Çështja mbetet sesi të kthehet Këshilli i Bashkisë në një pozitë më të mirë për t’i kërkuar llogari kryetarit për vendimet e tij. Lloji tjetër i llogaridhënies është ajo publike, e formale. Kryebashkiaku i Roterdamit e përfundoi fjalën e tij duke theksuar se është shumë e rëndësishme që aktorët në “trekëndësh” të kenë një bashkëpunim të mirë me njëri-tjetrin për të shmangur konfliktet dhe keqkuptimet e mundshme.



Z. ERION VELIAJ: NË SHQIPËRI DUHET TË KALOHEM NGA BASHKËPUNIMI AD HOC NË NJË RREGULLIM TË PËRHERSHËM



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj falënderoi IDM-në për ngritjen e një pune fantastike dhe paraqitjen e një panorame të asaj që ndodh në të gjithë vendin. Ai përmendi se mund të ndodhë që gjatë punës në bashki ndonjëherë të harrohet dhe të mos merret asnjë e dhënë


sesi funksionon kjo në qytetet e tjera. Puna e IDM-së krijon bazën që bashkitë të mund të kryejnë punën e tyre.

Kryebashkiaku i Tiranës theksoi se së pari, ekziston një ndryshim midis përvojave, pasi në Roterdam takimet konsultuese përcaktohen me ligj. Edhe nëse kryetari i bashkisë, shefi i policisë dhe prokurori nuk e pëlqejnë njëri-tjetrin, ata duhet të punojnë së bashku. Z. Veliaj shtoi se ky nuk është rasti në Shqipëri prandaj duhet parë sesi mund të shkohet nga bashkëpunimi ad hoc aktual në një rregullim të përhershëm. Ai shtoi se zakonisht takohen në kohë krize dhe kur kalojnë këto momente, ndonjëherë harrohet të vlerësohet se çfarë mësimesh janë mësuar, si mund të përmirësohen në të ardhmen, por edhe të planifikojnë infrastrukturën e përbashkët.



Takimi me drejtues të qeverisjes vendore,
datë 17 qershor 2020

Z. Veliaj nënvizoi se një gjë që po adresohet në planifikimin urbanistik është vendosja e komisariateve. Ai tha se janë duke bërë një eksperiment duke vendosur në të gjithë njësitë administrative stacione policie duke mundësuar që policia të takohet me komunitetin rregullisht. Ai e konsideroi shumë të rëndësishme krijimin e një hapësire të përhershme në lagje, ku qytetarët nuk mblihen në ambientet e një komisarjati, por në një hapësirë komunitare që është vërtetuar shumë e dobishme.




ZJ. VOLTANA ADEMI: NJË VENDIM I KËSHILLIT BASHKIAK PËR FORMALIZIMIN E TREKËNDËSHIT NË NIVEL BASHKIE

Zj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër, theksoi se aktorët e “trekëndëshit” bazohen në marrëdhënie të mira, por një bashkëpunim sipas një protokollit të caktuar do të ishte arritja më e madhe e gjithë këtij procesi disa vjeçar i cili formalizohet me një akt normativ. Përmes këtij akti, që mund të jetë edhe një vendim i Këshillit të Bashkisë, do të rregullohej marrëdhënia e “trekëndëshit” në mënyrë institucionale.

Ajo shtoi se pushteti vendor pavarësisht nëse e ka apo jo një çështje në interes apo përgjegjësi të tij, është ai pushtet që

duhet të interesohet për çdo çështje, duke theksuar se kjo nuk ndodh në Shqipëri për shkak të sistemit vertikal.


Kryebashkiakja e Shkodrës solli shembullin e takimeve të “trekëndëshit” nga i cili u vendosën kamerat e sigurisë për të monitoruar të gjithë kryqëzimet e qytetit të Shkodrës. Ajo theksoi se Këshilli Bashkiak është organi ligjvënës vendor për çështjet vendore që nuk i përkasin vetëm ekzekutivit, por mbarëvajtjes së gjithçkaje në qytetin e Shkodrës.



ZJ. ROMINA KUKO: KËSHILLAT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE TË VIHEN NË FUNKSION TË PARANDALIMIT TË KRIMIT

Znj. Romina Kuko, Zëvendësministre e Brendshme, vlerësoi faktin që IDM po i zhvillonte takimet konsultuese bazuar mbi një produkt konkret që mbledh

me interes të gjithë institucionet. Ajo përmendi rëndësinë e “trekëndëshit” për parandalimin e krimit dhe se ka ardhur momenti për të rihapur diskutimin lidhur



me parandalimin dhe për të hedhur hapa konkrete për të krijuar një fashë sigurie në këtë drejtim.

Zëvendësministrja theksoi se prokuroria është një hallkë e rëndësishme për krijimin e kulturës së ndëshkueshmërisë, e cila ka munguar, sidomos kur vjen puna për mbrojtjen e shtresave vulnerabël si të miturit apo rastet e dhunës ndaj grave. Zj. Kuko shtroi çështjen sesi mund të arrihet që “trekëndëshi” të blindojë dhe ofrojë siguri. Ajo përmendi sistemin holandez i cili ka specifikën e vetë, sepse kryetarët e bashkisë nuk janë të zgjedhur por të emëruar dhe ndërlidhja që ata kanë dhe pjesa hierarkike me drejtorin e policisë dhe prokurorin kanë një specifikë të ndryshme krahasuar me atë të Shqipërisë.

Z. Ferdinand Zera, Shef i Sektorit të Policimit në Komunitet në Policinë e Shtetit, theksoi se një nga prioritetet e policisë është rritja e besimit të qytetarëve duke theksuar se një nga format e bashkëpunimit të policisë është cilësuar ajo e partneritetit me Prokurorinë. Ai theksoi se, “trekëndëshi” duhet të përfshihet në legjislacion.

Zj. Kuko sugjeroi që diskutimi të vendosej në një platformë konkrete siç është Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP),

i cili është një strukturë në çdo bashki, e konstituuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Në KVSP-të do të duhet të hapim një diskutim për të marrë informacion se çfarë ndodh në territorin përkatës të asaj bashkie. KVSP duhet të ketë të pranishëm kryetarin e bashkisë, drejtorin e drejtorisë vendore të policisë, prokurorinë e rrethit, përfaqësues nga gjykatat, përfaqësues nga drejtoria e arsimit dhe shërbimeve sociale.

Zj. Kuko tha se do të organizoheshin disa vizita në bashki për të mbledhur KVSP-të dhe për të filluar një diskutim të strukturuar për sa i përket mjeteve parandaluese. Në fund të fjalës së saj, Zj. Kuko bëri thirrje për një qëndrim më reagues nga ana e policisë.

Vizioni i së ardhmes është që Këshillat Vendor të Sigurisë Publike të kthehen në një “qendër për politikat vendore të sigurisë”. Se si shkohet drejt këtij objektiv mund të shërbejnë edhe këto përvoja të reja:

- *Kryetari i Bashkisë Pogradec, pas takimit të “trekëndëshit”, fton prokurorin në mbledhjet e radhës së Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;*
- *Pas takimit të radhës të “trekëndëshit” në Bashkinë e Elbasanit, sfidat kryesore të evidentuara si dhe figurat kryesore të krimit bëhen pjesë e diskutimeve në takimin e radhës së Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;*
- *Në diskutimin e kryebashkiakut të Roterdamit botuar në këtë buletin mund të gjenden shumë episode që gjejnë vend edhe në përditshmërinë e punëve dhe sfidave të qeverisjes së bashkive në vend.*

Z. IDRIZ HAXHIAJ: FORMALIZIMI I "TREKËNDËSHIT" TË MBËSHTETET NË PROCEDURA INSTITUCIONALE DHE AKTE LIGJORE DHE NËNLIGJORE

Z. Idriz Haxhijaj, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Vendore, Ministria e Brendshme, shprehu vlerësimin e tij ndaj projektit të IDM-së dhe punën e policisë për të çuar përpara "trekëndëshin". Ai theksoi mbështetjen e Ministrisë së Brendshme për këtë projekt dhe për të tjera të ngjashme me atë të "trekëndëshit" të cilat kontribuojnë në vazhdimësi në emancipimin e institucioneve të sigurisë publike.

Ai shprehu se Policia e Shtetit (PSH) ka qenë një ndër organizatat më aktive duke plotësuar detyrimet e veta në kuadër të forumeve vendore apo qendrore ndër-institucionale. Ai shtoi se këto forma kanë ndihmuar PSH-në në njohjen reciproke të përgjegjësisë, ndarjen e detyrimeve si dhe në përcaktimin e prioritetëve të saj. Ai theksoi se emancipimi i institucioneve të sigurisë është domosdoshmëri, por ka të bëjë me kulturën, traditën dhe rezistencën mentale. Nëse Policia e Shtetit është duke ecur me hapa konkrete dhe të sigurt, e njëjta gjë duhet synuar edhe nga dy komponentët e tjerë si prokuroria dhe njësitë e qeverisjes vendore. Policia e Shtetit po bën të pamundurën për rritjen e rolit të komunitetit në sigurinë publike, përmes komisarariatit digjital, me aksesin e qytetarit në informim dhe në bashkëpunim me PSH-në, me funksionimin e oficerëve të sigurisë nëpër shkolla, me përfshirjen e organeve të zgjedhura apo të përfaqësuesve të komunitetit.

Lidhur me organet e qeverisjes vendore, ai shtoi çështjen lidhur me rolin e tyre në parandalimin e krimit. Z. Haxhijaj shprehu se nuk është Policia e Shtetit i vetmi institucion për të kontribuar në sigurinë publike dhe parandalimin e krimit. Roli i njësisë të qeverisjes vendore merr po kaq



Takimi me përfaqësues të Policisë së Shtetit, datë 10 qershor 2020

rëndësi sa edhe Ministria e Brendshme apo Policia e Shtetit. Ai sugjeroi moskufizimin e rolit të "trekëndëshit" vetëm në parandalimin e krimit. Për më tepër shtoi problemet e mbrojtjes nga zjarri, mungesa e shërbimeve publike dhe vazhdimësisë së tyre në raste të fatkeqësive natyrore dhe të pandemive. Komuniteti kërkon shërbime dhe është po aq i rrezikuar nga mungesa e tyre. Të gjitha këto çojnë në adaptimin e "trekëndëshit" për sigurinë publike dhe parandalimin e krimit. Z. Haxhijaj propozoi se "trekëndëshi" mund të adaptohet në projektin e konstituimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe se praktikat që kanë rezultuar me sukses duhen mbështetur me ndryshime dhe sanksionimin e tyre në bazën e duhur ligjore.

Z. Xhavit Shala, Drejtor i Kërkimit në Akademinë e Sigurisë ishte skeptik në lidhje me statistikat e krimit dhe saktësinë e tyre. Ai e vlerësoi rolin Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike si vendimtar për bashkëpunimin e institucioneve të ndryshme dhe duhet të përfshijnë drejtoritë arsimore. Ai shtoi se kandidatët që aspirojnë të bëhen kryetarë bashkie duhet të kenë në programet e tyre zgjedhore edhe çështje të sigurisë.

Ai theksoi se shtrirja e konceptit strategjik dhe qëllimit të strategjisë së sigurisë publike kanë si objektiv kryesor diversifikimin e shtimit e numrit të

aktorëve në garantimin e sigurisë publike, pasi nuk mund të jetë vetëm Policia e Shtetit autoriteti i vetëm për të kontribuar në sigurinë publike, por duhet të jenë të gjithë aktorët e “trekëndëshit”, shkollat, autoritetet rrugore, shëndetësore dhe shumë të tjerë që sot e luajnë rolin e tyre në mënyrë të pjesshme duhet të marrin përsipër detyrimet e tyre. Ai përfundoi fjalën e tij duke theksuar se formalizimi i “trekëndëshit” do t’i paraprinte këtyre praktikave duke i kthyer në koncepte strategjike, në procedura institucionale dhe duke i mbështetur edhe me akte ligjore dhe nënligjore.



Z. BILBIL MEMA: DUHET MATERIALIZUAR “TREKËNDËSHI” PËRMES TRAJNIMEVE TË VAZHUESHME NË AKADEMINË E SIGURISË



Dr. Bilbil Mema, Drejtor i Akademisë së Sigurisë, shprehu se në momentet kur po transformohet shoqëria dhe Policia e Shtetit është mirë që ekzistojnë qasje të tilla që kanë të bëjnë me integritetin dhe emancipimin e institucioneve. Nga kjo pikëpamje, ai theksoi se institucioni të cilin drejton nuk duhet të ishte i mbyllur, për sa i përket materializimit dhe vazhdimësisë që duhet të ketë kjo lloj pune e bërë deri tani.

Drejtori i Akademisë së Sigurisë e vlerësoi

përvojën e “trekëndëshit” që duhet të përfshihet në kurrikulën e Akademisë së Sigurisë. Ai e cilësoi modelin e “trekëndëshit” si një punë shumë të rëndësishme të IDM-së, duke shprehur se puna e policisë kryhet në komunitet dhe nuk ka asnjë arsye për të mos u përfshirë në këto përvoja. Drejtori i Akademisë së Sigurisë shprehu se pavarësisht sistemit vertikal që ka Policia e Shtetit në Shqipëri, në krahasim me sistemin horizontal të Holandës, ajo ka detyra të njëjta dhe i kryen ato me përpikëri.

Ai theksoi se qasja e policisë ka ndryshuar nga modeli i mëparshëm i sigurisë kombëtare drejt asaj të sigurisë së publikut, e cila në thelb ka sigurinë e individit. Ai theksoi se detyra e parë e punës së policisë në komisarate është të bashkëpunojë me Bashkinë, pasi ata janë të zgjedhurit e komunitetit për të qeverisur. Bashkia është ai institucion që menaxhon qytetin nga të gjitha pikëpamjet, duke shtuar se të gjithë llojet e kriminalitetit



që ekzistojnë janë të lidhur me mënyrën e qeverisjes dhe bashkëpunimit me qeverisjen vendore. Dr. Mema shprehu se policia nuk do të mund të ketë asnjëherë sukses dhe të realizojë misionin e saj pa ndjekur qasjen e ndërveprimit me komunitetin dhe menaxhimin e tij.

Dr. Mema cilësoi segmentin tjetër të “trekëndëshit”, prokurorinë, që ka pasur një bashkëpunim të mirë me Policinë e Shtetit, gjë që është parë edhe nga rezultatet e zbulueshmërisë së kriminalitetit. Ai shtoi se institucioni i prokurorisë nuk është institucion ekzekutiv siç është policia. Drejtori i Akademisë së Sigurisë theksoi se policia është pjesë e ekzekutivit dhe ka detyra me ligj Ndërsa prokuroria është e domosdoshme që ta ketë policinë për të bashkëpunuar dhe

për ta ndihmuar atë nga pikëpamja e zbulimit të kriminalitetit. Ai shtoi se policia ka disa probleme lidhur me ndryshimet e nevojshme që duhet të ndërmarrë, por përmendi edhe disa aspekte pozitive dhe arritje të Policisë së Shtetit duke theksuar se është e vështirë të zbulosh krime të rënda për 48 orë po që janë zbuluar nga ajo.

Ai theksoi se duhet materializuar “trekëndëshi” duke ofruar trajnime të vazhdueshme në të ardhmen për studentët që do të vijjnë në akademi. Lidhur me këtë, drejtori i Akademisë së Sigurisë solli në vëmendje se hartimi i tri moduleve të trajnimit mbi etikën dhe integritetin janë pjesë e kurrikulës zyrtare falë ndihmës së IDM-së.



Z. SOKOL STOJANI: KJO QASJE PARANDALUESE ËSHTË NË LINJË ME VIZIONIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Z. Sokol Stojani, Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit Institucional, Prokuroria e Përgjithshme, shprehu konsideratat lidhur me organizimin e këtij takimi dhe e priti me kënaqësi ftesën lidhur me takimin për parandalimin e krimit dhe sigurinë publike. Qëllimet e kësaj nisme për një partneritet horizontal të institucioneve me qytetarët është në të njëjtën qasje dhe vizion që ka shpalosur Prokurori i Përgjithshëm.

Z. Stojani shprehu se Prokurori i Përgjithshëm nuk i shikon institucionet të punojnë të veçuar, por ato duhet të bashkojnë vullnetin e tyre dhe të punojnë së bashku qoftë me partnerët e tyre dhe me qytetarët. Ai shtoi se në këtë këndvështrim është synuar gjithmonë jo vetëm rritja e kredibilitetit të institucioneve në mënyrën sesi funksionojnë, por edhe rritja e besueshmërisë së këtyre organeve para publikut. Kështu organizimi i takimeve duke përfshirë edhe organe të



tjera jo shtetërore si dhe rritja e frekuencës së këtyre takimeve për problematikat e hasura gjatë punës, do të sjellë rritjen si përgjegjësive e tyre në raport me njëri-tjetrin ashtu dhe të përgjegjshmërisë në punë.


Z. Stojani theksoi se Prokuroria ka në legjislacion të përcaktuar si ushtrimin e ndjekjes penale, a shtu edhe parandalimin. Ai shtoi se një pjesë e

rëndësishme e Prokurorisë është edukimi i opinionit publik lidhur me legjislacionin penal, një pjesë e kësaj është përfshirë edhe në planin strategjik 2018-2019 që lidhet gjithmonë me informimin dhe edukimin e publikut. Takimet e përbashkëta që mund të organizohen qoftë me pushtetin lokal qoftë me Policinë e Shtetit, në kuptimin e informimit publik për vepra të caktuara duke identifikuar problematikat, shkaqet, rrethanat, bëjnë që edhe publiku të rrisë interesin për t'u informuar.

Për më tepër, theksoi se janë disa vepra penale shqetësuese që tërheqin vëmendjen e opinionit publik si prodhimi dhe shitja e narkotikëve apo dhuna në çdo lloj forme, të cilat janë çështje që nuk duhet të shihen vetëm nga perspektiva e dënimit penal.

Zj. Elona Alvora, Prokurore në Prokurorinë e Rrethit në Vlorë deklaroi se ka identifikuar dy nga shkaqet kryesore të krimit në Vlorë. E para lidhet me varfërinë dhe arsimin. E dyta ishte lidhur me vetëdijen e dobët të qytetarëve për legjislacionin. Ajo theksoi që Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike në Vlorë nuk mund të jenë zgjidhje për probleme të ndryshme sociale.

Z. Stojani ndau me pjesëmarrësit e takimit se nuk ekziston një databazë ku të tregohet se kush janë shkaqet, rrethanat, faktorët që kanë ndikuar në




Takim me përfaqësues të prokurorisë, datë 3 qershor 2020

rritjen e kriminalitetit. Ai theksoi se është në vizionin e Prokurorisë së Përgjithshme modernizimi i sistemit të statistikave për të dhënë mundësi jo vetëm institucioneve të ndjekjes penale, qeverisë, kuvendit, etj., por edhe botës akademike, qytetarëve, shoqërisë civile për të realizuar studime lidhur me shkaqet dhe rrethanat e krimeve të ndryshme dhe të orientojnë institucionet në politikat për parandalimin e krimit. Ai bëri thirrje për bashkëpunimin midis institucioneve duke theksuar se duhet të bashkojnë vullnetin dhe ta bëjnë modelin më funksional.

Duke u nisur nga rezultatet e studimeve në Kosovë dhe Serbi, z. Stojani, shtoi se drejtuesit e institucioneve nuk përfaqësojnë vetëm veten e tyre, por janë aty si përfaqësues të institucioneve. Në këtë këndvështrim duhet vendosur një sistem rregullator se si duhet të funksionojnë marrëdhëniet midis aktorëve të “trekëndëshit”. Z. Stojani cilësoi se bashkëpunimi për të çuar deri në fund rezultatin do ta bëjë modelin funksional dhe se produkti final është shumë i rëndësishëm. Ai ndante në parim të njëjtin vizion për parandalimin e krimeve dhe rritjen e besueshmërisë.

Ai propozoi përdorimin e termit takime “konsultuese” në vend të takime “llogaridhënese”, sepse llogaridhënia e prokurorisë bëhet përpara Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Parlamentit, në këtë kuptim nuk shkon që prokurori të japë formalisht llogari para publikut. Ai shpjegoi që takime të tilla informojnë publikun dhe sugjeroi se ato duhet të mbahen jo më pak se dy herë në vit dhe se duhet të ketë fleksibilitet për drejtuesit që marrin pjesë në takimet.



ZJ. PRANVERA PUSTINA: BESIM NË ROLIN E "TREKËNDËSHIT" PËR TË RRRITUR KONSULTIMIN ME QYTETARËT E GRUPET E INTERESIT



Zj. Pranvera Pustina, Drejtore e Kabinetit të Prokurorisë së Përgjithshme, përgëzoi takimin dhe ndau vizionin e njëjtë me IDM-në dhe e vlerësoi si frytdhënës takimin e "trekëndëshit" midis përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Nëse flitet për prokurorinë, për shkak të përcaktimeve kushtetuese edhe ligjore prokuroria ndërhyr në një fazë më vonë, kur ka ndodhur krimi. Në atë fazë është e vështirë që të korrigjohet pasojat dhe t'i rikthejmë palët në gjendjen e mëparshme, aq më tepër kur dhuna le pasoja në familje dhe shoqëri. Ajo theksoi se nuk duhet të keqkuptohet roli i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, i cili nuk ka një rol vendimmarrës, por nëse arrihet konsultimi

dhe informimi i komunitetit, e ardhmja do të jetë më e mirë.

Zj. Farie Vata, Prokurore në Prokurorinë e Rrethit në Kukës ndau mendimet e saj në lidhje me modelin e "trekëndëshit". Ajo theksoi se zbatimi i modelit të "trekëndëshit" do të rrisë përgjegjësinë e publikut dhe institucioneve që zbatojnë ligjin dhe se pjesëmarrja e prokurorisë në modelin e trekëndëshit do t'i edukojë qytetarët për legjislacionin, parandalimin e krimit dhe do të rrisë vetëdijen e tyre për të raportuar krimet.


Zj. Pustina ndau me pjesëmarrësit se prokuroria po modernizon sistemin e statistikave duke e bërë më fleksibël dhe duke integruar statistika që kërkohen nga institucione të ndryshme shtetërore, organizata jo fitimprurëse dhe ndërkombëtare dhe të mund të gjenerojmë të dhënat sipas nevojave. Zj. Pustina shprehu se beson në rolin e "trekëndëshit" për të rritur konsultimin dhe për të kontribuar në parandalimin e krimit.

Z. GLEDIAN LLATJA: TAKIMET E "TREKËNDËSHIT" I MUNDËSOJNË QYTETARËT QË TË NJIHEN ME PUNËN E INSTITUCIONEVE VENDORE

Kryetari i Bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja falënderoi për takimin dhe për bashkëpunimin me IDM-në për organizimin e takimeve të cilat i cilësoi si

të suksesshme dhe risi në llogaridhënien publike pasi mbledhjet më parë zhvilloheshin me dyer të mbyllura. Z. Llatja theksoi se takimet e "trekëndëshit" kanë





mundësuar që vetë qytetarët të njihen me punën e bërë nga institucionet.

Z. Llatja tha se Bashkia Elbasan ishte bashkia e parë që ngriti Këshillin Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) duke pasur një bashkëpunim të mirë me institucionet lokale, komunitetet fetare, shoqërinë civile, dhe me partitë politike të cilat janë pjesë e këtij Këshilli, duke shtuar se siguria është një ndër interesat më prioritare të Bashkisë Elbasan. Kryetari i Bashkisë vuri në dukje se ka qenë sfiduese për stafet administrative të bashkive të kuptonin rëndësinë e Këshillit dhe të sigurisë publike në veçanti, pasi është parë si një pjesë që i takonte ose policisë,

prokurorisë apo organeve të tjera që mund të merreshin me sigurinë publike, por në të vërtetë është një detyrë e drejtpërdrejtë e bashkive dhe stafeve të bashkive.

Ai theksoi se bashkëpunimi institucional i degëve dhe njësive administrative është një përvojë e suksesshme. Duke pasur bashkë në zyrë punonjësit e pushtetit vendor, zyrat e punonjësve të Policisë së Shtetit apo edhe të institucioneve të tjera që merren me rendin publik ka sjell një efikasitet dhe bashkëpunim shumë të mirë duke e parë secilin si koleg pune dhe duke pasur një bashkëpunim ditor ndërmjet këtyre strukturave vendore.

Kryebashkiaku i Elbasanit theksoi se janë evidentuar dhe diskutuar në KVSP problematikat e qytetit dhe problemet me krijimin ose replikimin të së njëjtës strukturë në fshat dhe duke e ndarë qytetin në lagje dhe duke vendosur edhe aty një person me kompetenca të ngjashme si kryepleqtë. Ai shtoi se bashkëpunimi institucional për evidentimin e rasteve dhe për zgjidhjen e problematikave ka qenë efektiv.

Z. SOTIRAQ HRONI: TAKIMET PERIODIKE DHE PUBLIKE TË "TREKËNDËSHIT" BASHKI-POLICI-PROKURORI SI BAZË PËR NDËRTIMIN E AGJENDËS VENDORE TË SIGURISË

Në takimet e zhvilluar online gjatë muajit qershor, z. Sotiraq Hroni, Drejtor Ekzekutiv i IDM dhe autor i dokumentit të politikave mbi rolin e "trekëndëshit" bashki-polici-prokurori, vuri në dukje se përvoja e zbatimit të takimeve² konsultuese vendore ka pasur një mbështetje nga të gjithë aktorët e këtij trekëndëshi,

institucionet e tjera dhe komunitetet vendore. Duke iu referuar diskutimeve gjatë këtyre takimeve, z. Hroni theksoi se prokurorët e kanë bërë trekëndëshin më të besueshëm me praninë dhe kontributin e tyre. Ai shprehu vlerësimin e tij lidhur me vizionin e Prokurorit të Përgjithshëm për domosdoshmërinë e

••••


2 Buletin Nr. 5 <https://idmalbania.org/download/7257/>



takimeve të trekëndëshit që i shërbejnë mirëinformimit të publikut për tendencat e krimit, edukimit ligjor të shoqërisë dhe parandalimit të krimit.

Gjithashtu, z. Hroni shtoi se nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi midis institucioneve nuk duhet të konsiderohet si një akt, por si fillimi i një procesi të gjatë dhe të vetëdijshëm mbështetur në zhvillimin e një vizioni të përbashkët të institucioneve. Ky proces gradualisht do të çojë drejt rregulimeve ligjore dhe rregullatore për ta bërë sa më të qëndrueshme dhe efektiv këtë partneritet të institucioneve të zbatimit të ligjit në nivel vendor.

z. Hroni theksoi se kuptueshmëria e filozofisë dhe praktikës së policimit në komunitet është e plotë vetëm nëse punohet për të realizuar një partneritet horizontal të institucioneve në nivel vendor. Takimet periodike të “trekëndëshit” bashki-polici-prokurori dhe hapja e tyre përmes takimeve publike konsultuese vendos qytetarin në qendër të përpjekjeve për ndërtimin e agjendës vendore të sigurisë. Për të shpjeguar më konkretisht këtë ide, z. Hroni iu referua dy raporteve të organizatave nga rajoni si Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) dhe Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë (KCSS) të cilat kanë studiuar dhe monitoruar punën e Këshillave Vendor të Sigurisë në vendet respektive. Gjetjet reflektuan se dy sfida kryesore gjatë implementimit të KVS në Serbi dhe Kosovë janë “karakterin formal” i tyre dhe së dyti “mungesa e përfshirjes aktive të qytetarëve”. Takimet publike konsultuese të “trekëndëshit” eliminojnë karakterin formal, njëherazi përfshijnë të gjitha institucionet si dhe qytetarët “në ndërtimin e agjendës vendore të sigurisë”.



Cilat janë përfitimet e Policisë së Shtetit nga pjesëmarrja në takimet publike të “trekëndëshit” apo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike?

- Hapje dhe përgjegjshmëri publike ndaj kërcënimeve të sigurisë;
- Vendos frymë bashkëpunimi dhe partneriteti me të gjithë aktorët publikë dhe jo-publikë duke i shfrytëzuar dhe përdorur për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së policimit në komunitet. Kjo strategji vendore merr bashkëpronësi publike dhe nuk mbetet më një dokument nëpër sirtarë;
- Përcjell problematikën e sigurisë, konfliktet e pronësisë apo çdo formë tjetër, çështjet të dhunës në familje apo sigurinë në shkolla duke e bërë pjesë të agjendës së të gjithë institucioneve;
- Përdor komunikimin periodik institucional me këshillin bashkiak në dobi të saj duke influencuar vendimmarrjen vendore;
- Përdor burimet njerëzore dhe financiare të bashkisë në interes të sigurisë publike;
- Së bashku me qeverisjen vendore dhe prokurorinë, koordinon përpjekjet për parandalimin e krimit në shkolla.

POLICI

BASHKI

PROKURORI

INTEGRITET



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands